



ЕЛИМИНАЦИЈА НА МАЧЕЊЕТО
И НЕЧОВЕЧКОТО ПОСТАПУВАЊЕ
ВО ЗАТВОРИТЕ И УСТАНОВИТЕ
ЗА ЛИШУВАЊЕ ОД СЛОБОДА

**RAPORT MBI
VIZITAT PASUESE PËR
SITUATËN DHE KUSHTET
NË INSTITUCIONET
NDËSHKIMORE-KORREKTUESE
NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT
NË KORRIK 2021**

SHKUP, SHTATOR 2021

Наслов на оригиналот:

ИЗВЕШТАЈ ОД ПОСЛЕДОВАТЕЛНИ ПОСЕТИ ЗА СОСТОЈБАТА И УСЛОВИТЕ ВО
КАЗНЕНО-ПОПРАВНИТЕ УСТАНОВИ ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
ВО ЈУЛИ 2021

Botues: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut,
përfaqësuar nga kryetarja Prof. Dr. Neda Zdraveva

Redaktimi: Prof. Dr. Gordana Lazhetiq

Autorë: Ina Xhugumanova dhe Arben Gudaçi

Përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe: Shenasi Jaji

Lektorimi: Elizabeta Poljoska

Dizajni grafik dhe shtypja: Masiva Doel Shkup

Vendi i botimit: Shkup

Viti i botimit: 2021

Tirazhi i botimit: 100 ekzemplarë

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
343.811(497.7)(047.31)"2021.7"
061(047.31)"2021.7"

XHUGUMANOVA, Ina

Raport mbi vizitat pasuese për situatën dhe kushtet në institucionet
ndëshkimore-korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut në korrik
të vitit 2021 / [Ina Xhugumanova dhe Arben Gudaçi ; përkthim nga gjuha
maqedone në gjuhën shqipe Shenasi Jaji]. - Shkup : Komite i Helsinkit
për të drejtat e njeriut, 2021. - 25 str. ; 18 cm

Превод на делото: Извештај од последователни посети за состојбата и
условиите во казнено-поправните установи во Република Северна Македонија
во јули 2021

ISBN 978-608-4977-01-8

1. Gudaçi, Arben [автор]

а) Хелсиншки комитет за човекови права (Скопје)-- Извештаи б)
Казнено-поправните установи-- Услови-- Македонија-- Јули 2021--

Извештаи

COBISS.MK-ID 55431173



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian



Македонско здружение на млади правници



Ky botim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e
ShMJR-së dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
KALENDARI I AKTIVITETEVE	5
REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	6
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE KUMANOVË	8
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE SHTIP	11
INSTITUCIONI NDËSHKIMOR-KORREKTUES – BURGU TETOVË	14
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË ME PAVIJON TË HAPUR NË VELES/SHTËPIA EDUKATIVE-KORREKTUESE PËR GRA NË SHTËPINË NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË	18

HYRJE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Eliminimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor në burgjet dhe qendrat e paraburgimit”, financiarisht i mbështetur nga Bashkimi Evropian. Për qëllimet e projektit, u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi midis Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Raporti bazohet në vizitat në terren nga ana e një përfaqësuese e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut - Ina Xhugumanova, përfaqësuesit e Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj - Arben Gudaçi, si dhe ekspertë të jashtëm të angazhuar nga ekipi i monitorimit, psikiatrja Marija Kostadinovska dhe psikoterapeutja Elisaveta Sekullovskaja. Ekspertët u angazhuan për ta vlerësuar ndikimin e mundshëm të kushteve materiale në burgjet dhe ambientet e paraburgimit të personave që qëndrojnë në këto institucione. Vlerësimi është kryer duke ofruar këshillim psikiatrik dhe psikoterapeutik për personat e dënuar dhe duke biseduar me shërbimet profesionale në institucionet ndëshkimore-korrektuese, kryesisht me punonjësit shëndetësorë dhe ata socialë.

Vizitat në terren janë kryer gjatë muajit korrik të vitit 2021, si vizita pasuese të njëpasnjëshme të vizitave të rregullta, të cilat i ka kryer ekipi i monitorimit në periudhën midis gushtit dhe tetorit të vitit 2020.

Vizitat pasuese në terren u kryen në 4 institucione ndëshkimore-korrektuese në të cilat u vërejtën numri më i madh i mangësive gjatë

kohës së zhvillimit të vizitave të rregullta, përkatësisht në: SHNK Idrizovë, SHNK Shtip, SHNK Kumanovë dhe INK Tetovë.

Edhe pse gjatë vizitave pasuese ekipi i monitorimit vuri re një përmirësim në institucionet ndëshkimore-korrektuese, kryesisht në drejtim të përmirësimit të kushteve materiale, sistemi penitenciar ende përballet me probleme dhe sfida të mëdha. Problemet më urgjente mbeten qasja në kujdesin shëndetësor, procesi arsimor dhe procesi i risocializimit të personave të dënuar, menaxhmenti dhe stafi përgjegjës i pa trajnuar në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe mekanizmat joefikas të brendshëm dhe të jashtëm për raportimin dhe ndjekjen e rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor të personave të dënuar. Në këtë drejtim, raporti përmban një përmbledhje të monitorimit të kryer në terren, duke u fokusuar në progresin dhe sfidat kryesore të dokumentuara gjatë kohës së vizitave. Raporti gjithashtu përmban rekomandime për çdo institucion ndëshkimor-korrektues, si dhe rekomandime të përgjithshme për institucionet kompetente në mënyrë që të përmirësohet gjendja dhe kushtet në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe ato edukative-korrektuese.

KALENDARI I AKTIVITETEVE

SHNK Kumanovë	–	6.7.2021
SHNK Shtip	–	8.7.2021
INK Tetovë	–	13.7.2021
SHNK Idrizovë	–	15.7.2021

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

- Sigurimi urgjent dhe i menjëhershëm i kushteve minimale për mirëmbajtjen e higjienës, kushtet e gjumit dhe sigurimin e cilësisë dhe sasisë së ushqimit për të dënuarit në SHNK Idrizovë në përputhje me standardet e përcaktuara.
- Marrja urgjente dhe e menjëhershme e masave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për të siguruar akses të papen-guar në kujdesin shëndetësor për të gjithë personat e dënuar.
- Informimi i të dënuarve për të drejtat e tyre përmes fletushkave të informacionit, posterave, broshurave dhe të ngjashme, të cilat do të shfaqen në një vend të dukshëm dhe të frekuentuar në të gjitha institucionet ndëshkimore-korrektuese.
- Sigurimi i kushteve të përshtatshme materiale në institucionet në mënyrë që të mundësohet trajtimi njerëzor i të dënuarve.
- Angazhimi i personelit adekuat në institucionet lidhur me risocializimin, zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përshtatshme të risocializimit.



Zgjidhja afatgjatë e problemit të furnizimit me ujë në SHNK Kumanovë, duke e pasur parasysh faktin se uji është një e drejtë themelore e njeriut dhe mungesa e qasjes në ujë, veçanërisht në kushtet e pandemisë, rezulton me kushte çnjerëzore të jetesës për personat e dënuar.



Të bëhen përpjekje për punësimin e të dënuarve dhe zhvillimin e aftësive të punës që do të jenë të dobishme për ta pas përfundimit të vuajtjes së dënimit me burg.



Bashkëpunimi midis qendrave për punë sociale dhe Agjencisë së Punësimit me qëllim ofrimin e ndihmës postpenale për të dënuarit dhe përfshirjen e tyre në tregun e punës.



Zbatimi i një programi psikoterapeutik kognitiv për të dënuarit, i cili do të ishte një mundësi e shkëlqyer për zhvillimin personal të të dënuarve dhe përmbushja e programit individual të trajtimit për secilin të dënuar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burg.



Ministria e Arsimit të marrë masa për zbatimin e një procesi arsimor për personat e dënuar në institucionet ndëshkimore-korrektuese.

SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE KUMANOVË

Më 06.07.2021, ekipi i monitorimit i përbërë nga: Ina Xhugumanova, Marija Kostadinovska dhe Elisaveta Sekullovska kryen një vizitë në SHNK Kumanovë.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në kohën e vizitës në SHNK Kumanovë ishin gjithsej 145 të dënuar dhe 33 të paraburgosur, 10 prej të cilëve ishin shtetas të huaj.

KUSHTET MATERIALE

Në shtëpinë ndëshkimore-korrektuese, në krahasim me vizitën në shtator të vitit 2020, ekipi i monitorimit gjeti **dushe të rindërtuara në tualetet e përbashkëta** që nuk ishin funksionale më parë. Mund të konstatohet se institucioni ka bërë lavamanë të përbashkët në korridoret e reparteve në mënyrë që të dënuarit t'i lajnë duart, enët, etj., pa pasur nevojë të **shkojnë në tualetet e përbashkëta**, gjë që është shumë ndihmuese duke pasur parasysh që në dhomat ende nuk ka ujë. Ekipi i monitorimit vuri re se në hyrje të të gjitha reparteve, **të dënuarit janë angazhuar në punë për të ndërtuar një mur** dhe komandanti i institucionit na informoi se ndërtimi kishte për qëllim parandalimin e dhënies, shitjes ose tregtimit së sendeve/gjërave, substancave dhe të ngjashme të paligjshme midis personave të dënuar.

Mjediset e Izolimit në SHNK Kumanovë u gjetën në kushte të dobëta higjienike dhe nën standardet minimale. Shtretërit nuk kishin **dyshekë apo kishin dyshekë të ndotur, pa asnjë mbulojë. Karriget në dhomat e izolimit ishin të thyera**, për shkak të të cilave ekziston rreziku i (vetë) dëmtimit të të dënuarve ndërsa ata janë duke qëndruar në këto dhoma. Tualetet në dhomat e izolimit ishin në kushte shumë të këqija higjienike, kurse lavamanët në këto mjedise ishin krejtësisht të shtrembëruar, gjë që u shërbente të dënuarve të ngjiteshin në dritaren e dhomës për të folur me të dënuarit e tjerë, si dhe për të shkëmbyer artikuj dhe sende të tjera të paligjshme. **Sistemi i thirrjeve/alarmimit në dhomat e izolimit nuk funksiononte**, ndërsa drita në këto mjedise ndizet dhe fiket nga punonjësit e institucionit.

Shëtitorja për të burgosurit në repartin e mbyllur dhe dhomën e izolimit ishte bosh, me vetëm 1 portë futbollit.

MBROJTJA / KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor në institucionin sigurohet nëpërmjet një tekniku mjekësor i cili është i punësuar në institucionin me orar të plotë pune. Një mjek e viziton burgun dy herë në javë, kurse dentisti një herë në dy javë.

Asnjë psikiatër nuk është i angazhuar në këtë institucion. Psikiatri i angazhuar nga ekipi i monitorimit gjatë vizitës vuri re se nuk ka terapi të mjaftueshme mjekësore dhe për shkak të mungesës së një psikiatri, të dënuarit shpesh marrin terapi joadekuate që përshkruhet nga tekniku mjekësor. Të dënuarit nuk janë nën mbikëqyrje profesionale psikiatrike, gjë që ka një efekt veçanërisht të dëmshëm në shëndetin e tyre, por edhe në procesin e risocializimit të tyre.

Rekomandime:

- Gjetja e një zgjidhjeje afatgjatë për problemin e furnizimit me ujë;
- Pajisja e shëtitores për personat e dënuar në dhomat e izolimit, repartin e mbyllur dhe njësinë e paraburgimit;
- Ministria e Shëndetësisë të gjejë një zgjidhje për problemin me furnizimin me sasi të mjaftueshme të terapisë mjekësore dhe të bëhet përpjekje për të punësuar një psikiatër në institucionin;
- Personat e dënuar të marrin terapi mjekësore në periudhën e përcaktuar kohore nën mbikëqyrjen adekuate;
- Rindërtimi i tualeteve dhe karrigeve në dhomat e izolimit dhe pajisja e shtretërve të këtyre mjediseve me dyshekë, jastëkë dhe shtretër të pastër;
- Vendosja e një sistemi funksional të thirrjeve/alarmimit në dhomat e izolimit.

SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE SHTIP

Më 08.07.2021, ekipi i monitorimit i përbërë nga: Ina Xhugumanova, Marija Kostadinovska dhe Elisaveta Sekullovska kryen një vizitë në SHNK Kumanovë.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në kohën e vizitës, në SHNK Shtip kishte gjithsej 223 persona të dënuar, nga të cilët vetëm 1 ishte shtetas i huaj.

KUSHTET MATERIALE

Në shtëpinë ndëshkimore-korrektuese, në krahasim me vizitën në gusht të vitit 2020, gjetëm **një repart pritjeje të rindërtuar** në të cilin qëndronin 3 persona të burgosur. Në dhomën e repartit të pritjes nuk kishte dritë, kurse në tualetin u vu re një pasqyrë e thyer, e cila u hoq nga një anëtar i policisë së burgut me sugjerimin e ekipit të monitorimit. Higjiena në tualetin ishte në një nivel të kënaqshëm, me 3 lavamanë, 1 tualet dhe 3 dushe.

Institucioni, me mbështetjen financiare të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, **i ka rindërtuar plotësisht dritaret dhe dyert në të gjitha krahët e institucionit**, duke i zëvendësuar të vjetrat prej druri me dyer

dhe dritare PVC. Njëri prej tualeteve në 1 nga krahët ishte rindërtuar, ndërsa për tjetrin ende priten të arrijnë mjetet financiare për rindërtim.

Drejtori i SHNK Shtip informoi se nga vlerësimet e fundit kanë arritur në përfundimin se institucioni **ka kapacitet për vetëm 156 persona dhe jo për 210 persona siç ishte raportuar më parë**. Prandaj, ne ishim në gjendje të vërejmë se SHNK Shtip përsëri po përballet me **mbipopullim dhe të dënuarit po i vuajnë dënimet me burg në mjedise që nuk i plotësojnë standardet sa i përket madhësisë, gjerësisë dhe gjatësisë**.

Qelitë e izolimit akoma përdoren për të dënuarit që nuk vuajnë masë disiplinore - dënim në qeli izolimi, por nuk mund të transferohen në asnjë nga krahët e tjerë për shkak të mungesës së kapaciteteve ambientale. Këto ambiente nuk i plotësojnë standardet e kërkuara.

MBROJTJA/KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor ofrohet nëpërmjet një tekniku mjekësor dhe një mjeku, të cilët janë të punësuar në institucionin. Në këtë institucion nuk ka psikiatër, fakt që ka një efekt të dëmshëm në shëndetin mendor të të dënuarve, si dhe në procesin e risocializimit të tyre. Drejtori i institucionit na informoi se ata gjithashtu përballen me mungesë ilaçesh.

Në ditën e vizitës, personat e dënuar vaksinoreshin kundër virusit Covid-19. Nga gjithsej 223 persona të dënuar, 83 ishin regjistruar për vaksinim. SHNK Shtip është institucioni i parë ndëshkimor-korrektues që ka organizuar proces vaksinimi kundër virusit Covid-19 për personat e dënuar në Maqedoni.

ARSIMI

Në prill të vitit 2021, në SHNK Shtip ka filluar një proces arsimor për personat e dënuar. Në fillim, gjithsej 40 persona kishin aplikuar për ta ndjekur arsimin fillor. Prosesi arsimor zhvillohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe UNDP-së. Ligjëratat mbahen çdo ditë të javës përmes mësuesve të punësuar nga një shkollë fillore në Shtip.

Rekomandime:

- Marrja e masave për eliminimin e mbipopullimit në institucionin nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.
- Personat e dënuar nuk duhet ta vuajnë dënimin me burg në dhoma të destinuara për vuajtjen e masës disiplinore - dënim në qeli izolimi, për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm hapësinor;
- Ministria e Shëndetësisë të marrë masa për prokurimin e rregullt të barnave të nevojshme për terapi mjekësore të të dënuarve me probleme shëndetësore, të cilët në mungesë të tyre i furnizojnë me fonde private;
- Ministria e Shëndetësisë të marrë masa për të punësuar një psikiatër në institucionin;
- Angazhimi në punë i personave të dënuar brenda institucionit;
- Rindërtimi i disa prej tualeteve që janë ende në gjendje të keqe.

INSTITUCIONI NDËSHKIMOR-KORREKTUES - BURGU TETOVË

Më 13 korrik 2021 INK Burgu Tetovë u vizitua nga ekipi i monitorimit i përbërë nga: Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Marija Kostadinovska dhe Elisaveta Sekullovska.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në kohën e zhvillimit të vizitës, në INK Burgu Tetovë kishte 72 persona, kurse kapaciteti i përgjithshëm i institucionit është për 53 persona.

KUSHTET MATERIALE

Në këtë institucion ndëshkimor-korrektues, në krahasim me vizitën në gusht të vitit 2020, ne gjetëm se **në disa nga dhomat ishin zëvendësuar dyer dhe dritare dhe gjatë vizitës vërejtëm se edhe tualetet ishin në rindërtim e sipër**. Ekipi i monitorimit u informua se me ndihmën e donacioneve, drejtori i institucionit kishte siguruar **dyshekë dhe shtretër të rinj për personat e dënuar**.

Në INK Tetovë ende nuk ka **dhomë të veçantë të destinuar për vizita** dhe gjatë vizitës sonë vumë re se në oborrin e institucionit janë vendosur **stola dhe lëkundëse të reja** ku personat e dënuar mund të takohen me familjarët e tyre.

Shëtitorja e institucionit është ende bosh, pa pajisje të reja për aktivitete të lira dhe profesionale, kështu që përdoret vetëm për shëtitje. Brenda shëtitores ka një dhomë për palestër, një dhomë të veçantë që personat e dënuar e përdorin për të luajtur shah dhe si një kafene, por dhe një dhomë biblioteke, e cila është e pajisur dobët me libra, për të cilën ekipi rekomandoi që të kontaktohet biblioteka e qytetit.

Ajo që ekipi i monitorimit e identifikoi si një nga mangësitë është fakti se **në dhomën që shërben si repart për pritje ishin akomoduar 3 persona në repartin e pritjes dhe 1 person i cili po vuante masë disiplinore - dënim në qeli izolimi**. Anëtari i policisë së burgut dhe të dënuarit e tjerë e informuan ekipin e monitorimit se **kanë vetëm 1 orë gjatë ditës për një shëtitje**, për të cilën drejtori i institucionit u qortua menjëherë se të dënuarit kanë të drejtë të ecin 2 orë në natyrë gjatë ditës. Pranë repartin e pritjes, në momentin e vizitës, ishte duke u rindërtuar një ambient tjetër, i cili duhet të jete i destinuar për vuajtjen e masës disiplinore - dënim në qeli izolimi, në mënyrë që të ndahen dy kategoritë e personave.

Personat e dënuar që janë vendosur në repartin e pritjes u ankuan se bënin vetëm 1 dush gjatë javës. Drejtori i institucionit e informoi ekipin e monitorimit se për shkak të kufizimeve që i kanë me ujën, ndonjëherë ujë ka vetëm në orën 3 të mëngjesit dhe kjo është arsyeja se pse të dënuarit nuk janë në gjendje të bëjnë dush më shumë se një herë në javë. Të dënuarit u informuan për këtë rrethanë dhe drejtori u udhëzua të kërkonte deklarata prej tyre me të cilat ata do të bien dakord të zgjoheshin gjatë natës në mënyrë që të bënin dush, derisa të zgjidhej problemi i furnizimit të rregullt me ujë.

MBROJTJA/KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor sigurohet përmes një mjeku i cili është i punësuar me kohë të plotë në institucionin. **Ordinanca e mjekut është e vogël dhe shërben si zyrë e dy punonjësve të tjerë të institucionit.** Në një bisedë me mjekun, ekipi i monitorimit mori informacion se **nuk ka terapi të mjaftueshme mjekësore në institucionin** dhe të dënuarit detyrohen t'i blejnë vetë ilaçet e nevojshme.

Mjeku gjithashtu e informoi ekipin e monitorimit se **të dënuarit nuk kanë sigurim shëndetësor** dhe për këtë arsye kanë pengesa në arritjen e kujdesit shëndetësor të nivelit të dytë. **Asnjë psikiatër nuk është punësuar në institucionin,** për të cilën psikiatri i angazhuar nga ekipi i monitorimit arriti në përfundimin se ka një nevojë të madhe, duke pasur parasysh se numri i madh i të dënuarve ka nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme dhe të intensifikuar psikiatrike. Më shpesh, kjo kategori personash udhëzohen vetëm *ad hoc* për një ekzaminim të brendshëm nga një psikiatër kur është urgjente dhe e nevojshme, që do të thotë se shëndeti i tyre mendor nuk monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Rekomandime:

- Ministria e Shëndetësisë të marrë urgjentisht masa për prokurimin e terapisë mjekësore në institucionin dhe rregullimin e sigurimit shëndetësor të personave të dënuar;
- Ministria e Shëndetësisë të marrë masa për të punësuar një psikiatër në institucionin;
- Hapja e një dhome të re të destinuar për një ambulancë, ku mjeku do të jetë në gjendje t'i ekzaminojë të dënuarit pa praninë e punonjësve të tjerë, në mënyrë që ta mbrojë privatësinë e tyre;
- Të rindërtohet një dhomë tjetër e destinuar për vuajtjen e masës disiplinore - burg në qeli izolimi në mënyrë që këta persona të mund të ndahen nga personat e vendosur në repartin e pranimit;
- Të zgjidhet problemi i kufizimeve në furnizimin me ujë;
- Hapja e punëtorive dhe pajisja e shëtitores së institucionit në mënyrë që të dënuarit të kenë mundësi për cilësi më të mirë të aktiviteteve të lira dhe profesionale që janë veçanërisht të rëndësishme për risocializimin e tyre në shoqëri;
- Të dënuarve duhet t'u mundësohen 2 orë gjatë ditës për një shëtitje në natyrë;
- Pajisja e një dhome të veçantë me destinim për t'i kryer vizitat e personave të dënuar.

SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË ME PAVIJON TË HAPUR NË VELES/SHTËPIA NDËSHKIMORE- KORREKTUESE PËR GRA NË SHTËPINË NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË

Më 15.07.2021 SHNK Idrizovë u vizitua nga ekipi i monitorimit i përbërë nga: Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Marija Kostadinovska dhe Elisaveta Sekullovska.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në SHNK Idrizovë, në momentin e vizitës kishte gjithsej 1083 persona të dënuar.

KUSHTET MATERIALE DHE USHTRIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË DËNUAR

Në repartin e mbyllur të SHNK Idrizovë u vu re mbipopullim në ambientet e akomodimit, konkretisht në blloqet 1, 4 dhe 7, ku takuam persona të dënuar duke fjetur nëpër korridor, në dysheme, kurse në disa dhoma takuam 12-13 të burgosur në një dhomë të akomoduar në shtretër në 3 kate. **Dushet në tualetet e të gjitha dhomave ishin akoma të improvizuara dhe të bëra me fuçi, kurse në disa tualete të burgosurit**

bëjnë dush me kova. Të dënuarit që flenë në korridor nuk kanë tualet të tyre dhe duhet t'i përdorin tualetet e të dënuarve që kanë një dhomë. I gjithë instalimi elektrik (energji elektrike) është i hapur dhe paraqet një rrezik të lartë zjarri ose incidentesh të tjera. Ngrohësit e improvizuar të ujit përdoren nga të dënuarit të cilët gjithashtu paraqesin rrezik për jetën e tyre.

Në krahun 1 gjetëm 7 persona të dënuar, në krahun 4 gjetëm 5 të dënuar, kurse në krahun 7 gjetëm 4 persona të dënuar, **të cilët flinin në dysheme.** Një i dënuar nga krahu 1 ishte duke fjetur në një dyshek në dysheme në një nga dhomat, dy të dënuar në krahun 4 u gjetën duke fjetur në një shtrat të vetëm në korridor, kurse një i dënuar në krahun 4 flinte në një shtrat pa dërrasa, kështu që ai kishte vendosur një TV nën dyshek që të mund të flinte. Një nga të dënuarit në krahun 7 flinte në një batanije të shtrirë në dysheme. Në të gjithë ndërtesën, veçanërisht në blloqet ku u vu re mbipopullim, kishte një nivel shumë të ulët të higjienës. Për më tepër, të dënuarit e informuan ekipin e monitorimit se në 2-3 javët e fundit ata **nuk kanë ujë** për shkak të të cilës ata nuk mund të bëjnë dush, ta mbajnë higjienën personale dhe as t'i lajnë enët me të cilat hanë. Si rezultat, ndërtesa mbante erë të keqe, kurse në korridoret e dhomave u vunë re shumë pjata të palara plot miza dhe insekte të tjera.

Në kohën e vizitës, temperatura në qytet ishte 40 gradë Celsius. Ambientet e institucionit ku ishin akomoduar të dënuarit ishin dukshëm të ngrohta, por ata na njoftuan se drejtori i institucionit **nuk u lejonte të sillnin ventilatorë,** madje as nuk u ishin siguruar nga ana e institucionit.

Në krahun e 4-t, u vu re **një dritare e thyer** në korridoren e dhomave, e cila mund t'u shërbejë të burgosurve për (vetë)lëndim. Grupi i

monitorimit e udhëzoi policinë e burgut që ta përjashtonte menjëherë dritaren e thyer.

Qelitë e izolimit në institucionin janë në kushte dukshëm nën standarde me dyshekë të ndotur, shtroje të pista, tualet të lagur, të ndotur, si dhe dritë artificiale shumë të dobët. Një person i dënuar i cili ishte futur në qelinë e izolimit na informoi se ai kishte një përkeqësim të gjendjes shëndetësore, pra probleme me presionin e gjakut, për shkak të të cilave në një rast i kishte rënë të fikët. Ai u ankua se gjendja e tij shëndetësore nuk i lejon të jetë i vendosur në një qeli të izolimit.

Reparti i pranimit në institucionin u gjet gjithashtu në kushte të dobëta higjienike. Në dhomën kishte 18 shtretër dhe në kohën e vizitës ishin akomoduar gjithsej 6 persona. Tualeti në repartin e pritjes ka një nivel shumë të ulët të higjienës dhe ka një dush dhe 2 tualete. **Në tualetin u gjetën kablllo të energjisë elektrike**, të cilat shumë lehtë mund të shkaktonin zjarr dhe lëndime tek të dënuarit dhe në rastin më të keq, mund të çonin në vdekje. Të dënuarit kërkuan pajisje higjienike në mënyrë që ata të mund t'i pastronin ambientet.

Pjesa e vjetër e objektit që shërbente për t'i akomoduar të dënuarit që janë me trajtim mjekësor për një repart gjysmë të hapur, është mbyllur. Të dënuarit janë akomoduar në ndërtesën e re e cila ka përdhese dhe 2 kate, kurse numri i përgjithshëm i personave është 240. Edhe pse ndërtesa është e re, në katin përdhes kishte lagështi në tavanet dhe një mur që po shembej për shkak të lagështisë së madhe. Dhomat në këtë ndërtesë i plotësojnë standardet për nga gjerësia, madhësia, drita, lagështia, por të dënuarit kishin një sërë ankesash për shkak të mungesës së ujit, si dhe frigoriferë ku mund ta ruanin ushqimin gjatë periudhës së verës kur temperaturat janë shumë të larta dhe duke pasur parasysh që shumë prej tyre marrin pako ushqimore nga jashtë,

sepse objekti shërben, për shembull, vetëm 1 kanaçe peshk për dy persona, 1 kos të vogël për person për 3 vakte, një pjatë pire patatesh me 2 salsiçe për 4 persona etj. Problemi i mungesës së ujit u theksua përsëri në ndërtesën e re, kurse të dënuarit që ishin vendosur në katin e dytë të ndërtesës u ankuan se nuk kishin fare ujë për shkak të mungesës së presionit të ujit.

Si një **përparim pozitiv**, drejtori i institucionit e veçoi lëshimin në përdorim të hyrjes zyrtare për punonjësit në mënyrë që të ofrohet siguria e tyre, kontrolli i hollësishëm ditor i të gjithë punonjësve në hyrje dhe dalje të institucionit, 3 vende të reja parkimi për punonjësit, rindërtimi i dyerve dhe dritareve dhe lëshimi në përdorim i rrjetit kabllor në repartin e grave. Ai gjithashtu informoi se janë duke u zhvilluar përgatitjet për një ambient të ri për ambulancë dhe një ordinancë të re stomatologjike.

MBROJTJA/KUJDESI SHËNDETËSOR

Sa i përket kujdesit shëndetësor, SHNK Idrizovë ka dy mjekë të përgjithshëm, një psikiatër (i cili vjen në ditë të caktuara), tri infermiere dhe një stomatolog. Personeli mjekësor punon vetëm në ditët e punës, në një ndërrim, nga ora 7:30 deri në orën 15:30 dhe është përgjegjës për sigurimin e kujdesit shëndetësor parësor për të gjithë personat e dënuar në SHNK Idrizovë.

Psikiatri dhe psikoterapisti që ishin pjesë e ekipit biseduan me vetëm 6 të dënuar të vendosur në ndërtesën e “Ambulancës” sepse institucioni **nuk kishte arritur të bënte një listë të njerëzve** që donin të konsultoheshin me një psikiatër/psikoterapist.

ANKESAT NGA ANA E TË BURGOSURVE DHE OFRIMI I NDIHMËS JURIDIKE

Gjatë kohës së vizitës, pesëmbëdhjetë të dënuarve iu ofrua ndihmë e drejtpërdrejtë juridike në lidhje me një çështje specifike juridike.

Në përgjithësi të dënuarit u ankuan për kushtet në institucionin, kryesisht për mungesën e ujit. Të dënuarit përballen me këtë problem për gati tre javë për shkak të të cilës ata kanë vështirësi në mirëmbajtjen e higjienës, larjen e enëve, pastrimin e ambienteve dhe të ngjashme, që paraqet një problem i madh veçanërisht në një periudhë kur temperaturat janë dukshëm të larta.

Për më tepër, disa nga të dënuarit u ankuan se për shkak të mbipopullimit në institucionin ata **flenë në dysheme ose në shtretërit nëpër korridore**, madje disa për javë dhe disa për muaj të tërë.

Sa i përket ushqimit, të dënuarit kanë një sërë ankesash **se ushqimi është aq i keq** saqë detyrohen të hanë vetëm nga paketat ushqimore që i marrin nga shtëpia. Ata që nuk kanë mundësi financiare për të blerë ushqime nga jashtë ose nuk kanë njerëz të afërt që t'u sjellin ushqim, hanin nga ushqimet e burgut, të cilat ata thonë se janë të tmerrshme. Ata u ankuan se merrnin vetëm 1 krem të vogël për mëngjes, 1 kanaçe peshk për drekë për dy persona, 1 kos të vogël për të 3 vaktet gjatë ditës dhe të ngjashme. Ata që e marrin ushqimin nga shtëpia kanë frikë se do t'u priset për shkak të temperaturave të larta dhe drejtori i institucionit nuk i lejon të blejnë frigoriferë, edhe pse në disa pavijone/reparte u vu re se të dënuarit kishin frigoriferë për ushqim. Të gjitha vaktet u shërbehen menjëherë dhe më shpesh për shkak të mbipopullimit, të dënuarit detyrohen t'i ndajnë ushqimet e tyre në dysh. Për më tepër, buka shpërndahet në hyrje të korridoreve, në

vendet që kanë një nivel të ulët higjiene dhe ku ka prani të insekteve të ndryshme.

Pothuajse të gjithë të dënuarit me të cilët biseduam **e vunë në dukje problemin që e kanë me insektet (buburrecat, brumbujt, etj.) në dhomat e gjumit dhe shumë prej tyre kishin gjurmë kafshimi nga insektet.**

Disa nga të dënuarit gjithashtu u ankuan për qasjen e vështirë në kujdesin shëndetësor, domethënë se **burgu nuk e ofron terapinë e nevojshme mjekësore** ose se ata nuk mund të vijnë të ekzaminohen nga një mjek, edhe pse ata kanë paraqitur një kërkesë me shkrim për ekzaminim mjekësor.

PAVIJONI/REPARTI I GRAVE

Reparti i veçantë në SHNK Idrizovë për gratë që vuajnë dënim me burg (në tekstin e mëtejshëm: reparti i grave) funksionon si një strukturë e veçantë dhe e ndarë në SHNK Idrizovë, ku janë akomoduar gjithsej 66 gra. Brenda repartit të grave, ekziston edhe një shtëpi edukative-korrektuese për gratë. Gjatë kohës së vizitës, në këtë institucion ishin akomoduar 3 të mitura.

Në repartin e grave ishte bërë një rindërtim i plotë i dyerve dhe dritareve dhe ishte instaluar një rrjet kabllor, kurse në zhvillim e sipër ishte edhe procedura për rindërtimin e dyshemesë.

Ajo që ekipi i monitorimit e vuri në dukje si një mangësi ishte mbikëqyrja jofunksionale me video në repartin, e cila është një pengesë për hetimin e çdo rasti të sjelljes së keqe ose torturës ndaj grave të burgosura të cilat **iu ankuan ekipit se komandantet shpesh përdorin forcë të tepruar fizike ndaj tyre dhe u drejtohen me fjalor abuziv**. Gratë e burgosura u ankuan se u mungon të kenë biseda me një psikolog, si dhe më shumë aktivitete të lira dhe profesionale, sepse përveç shikimit të televizorit dhe ecjes në oborr, ata nuk kanë ndonjë mënyrë tjetër se si ta kalojnë kohën.

Disavantazhi ishte se gratë e burgosura nuk kanë lavanderi dhe janë të detyruara t'i lajnë me dorë rrobat e tyre.

Kohët e fundit, Shoqata “Viktima” nga Shkupi në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve e zbaton projektin “Rehabilitimi i grave të burgosura”, i mbështetur financiarisht nga Civika Mobilitas, përmes të cilit gratë kanë mundësi t'i ndjekin ushtrimet e jogës disa herë në muaj brenda ambienteve të institucionit. Aktivitete të tilla duhen përshëndetur sepse ato ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e risocializimit të grave të burgosura.

Rekomandime:

- Ndërmarrja e menjëhershme e masave për zgjidhjen e mbipopullimit në institucionin;
- Marrja e masave urgjente për të gjetur një zgjidhje për problemin e furnizimit me ujë;
- Sigurimi i 3 vakteve gjatë ditës për të gjithë të dënuarit që do t'i plotësojnë vlerat ushqyese të parashikuara nga Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve;
- Institucioni duhet të sigurojë ose t'u mundësojë të dënuarve të blejnë ventilatorë gjatë periudhës së verës kur temperaturat janë dukshëm të larta;
- Rindërtimi i plotë i repartit të mbyllur dhe ndërtesës “Ambulanca” ose hapja e objekteve krejtësisht të reja;
- Ministria e Shëndetësisë të marrë urgjentisht masa për prokurimin e barnave të nevojshme që aktualisht të dënuarit i paguajnë me fonde personale;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve ta zgjidhin problemin me sigurimin shëndetësor të të dënuarve që aktualisht nuk janë të siguruar dhe kanë pengesa në ofrimin e kujdesit dytësor shëndetësor;
- Zbatimi i menjëhershëm i dezinfektimit në të gjitha ambientet e SHNK Idrizovë për shkak të pranisë së brumbujve;
- Ministria e Arsimit të fillojë një proces arsimor në SHNK Idrizovë që do të jetë i qëndrueshëm me mjete financiare të shtetit;
- Krijimi i mbikëqyrjes funksionale me video në repartin e grave;
- Vendosja e posterave/afisheve me të drejtat e personave të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit me burg;
- Pajisja e shëtitores me disa rekuizita për kalimin cilësor të kohës së lirë të të dënuarve;
- Angazhimi me punë i personave të burgosur.

**RAPORT MBI VIZITAT PASUESE PËR SITUATËN DHE KUSHTET NË
INSTITUCIONET NDËSHKIMORE-KORREKTUESE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT
NË KORRIK TË VITIT 2021**